



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR	
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA	
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING	
Njësia Org. Org.Jedinka Org.Unit	M-01
Nr.Prot. Broj.Prot. Prot.No	3955/26
Nr. ffaqeve Broj.stranica No.pages	03
Data: Datum: Date: 10.07.26	
PRISHTINË/A	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Datë: 10.07.2026

Ministria e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, duke u bazuar në nenin 17 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit dhe nenin 4, paragrafi 1.41, nenin 5, paragrafi 3, nenin 5, paragrafi 5.1.5, nenin 5, paragrafët 6.1 dhe 6.2 dhe nenin 10, paragrafët 2, 6.7, dhe 7, nenit 47, 48, 49 dhe 50 të Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina si dhe pas pranimit të ankesave të vazhdueshme nga qytetarët, merr këtë:

URDHËRESË

PËR MARRJEN E MASAVE URGJENTE, DERATIZIMIN DHE SHTIMIN E KUJDESIT GJATË SEZONIT TË VERËS PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Drejtuar: Të gjitha komunave të Republikës së Kosovës, institucioneve qendrore dhe lokale, spitaleve dhe institucioneve shëndetësore, ndërmarrjeve publike (përfshirë ato të menaxhimit të mbeturinave dhe të menaxhimit të infrastrukturës ujore/kanaleve), si dhe të gjitha subjekteve afariste private në cilësinë e poseduesve dhe gjeneruesve të mbeturinave.

Për shkak të temperaturave të larta, gjendja e raportuar nga qytetarët për vendosjen e kontejnerëve afër institucioneve edukative, parqeve përfshirë terrenet sportive dhe parqet e lodrave, në rrugët kryesore e me frekuentueshmëri të lartë nga kalimtarët, afër bizneseve të ushqimit dhe të gastronomisë si dhe stërmbushja e tyre, mungesa e kapakëve në kontejnerë, prania e mbetjeve nga bizneset dhe djegia e tyre, paraqet një rrezik serioz dhe të drejtpërdrejtë për shëndetin publik dhe mjedisin.

Duke marrë parasysh rrezikun e shtuar epidemiologjik, kjo situatë është bërë tejet alarmante me shfaqjen e pranisë së shtuar të brejtësve (minjve) dhe insekteve rreth këtyre zonave urbane, duke rritur rrezikun e drejtpërdrejtë për epidemi dhe përhapje të infeksioneve.

Prandaj, për të shmangur pasoja të pakthyeshme në shëndetin publik, **URDHËROHENI** që të ndërmerrni këto masa urgjente:

1. Masat Urgjente të Sezonit të Verës (Menaxhimi i Shtuar dhe Deratizimi)

- **Deratizimi dhe Dezinsektimi emergjent:** Të bëhet pastrimi i thellë, dezinfektimi dhe deratizimi (eliminimi i brejtësve) emergjent i hapësirave përreth kontejnerëve dhe pikave të grumbullimit. Kjo masë duhet të fillojë **brenda 48 orëve** nga pranimi i kësaj urdhërese.
- **Rritja e frekuencës:** Kompanitë e angazhuara për grumbullimin dhe menaxhimin e mbeturinave duhet të rrisin frekuencën e zbrazjes së kontejnerëve gjatë verës për të parandaluar fermentimin e mbetjeve nga nxehtësia.
- **Mbulimi i mbeturinave:** Kontejnerët duhet të pajisen menjëherë me kapakë funksionalë për të shmangur ekspozimin e mbeturinave ndaj rrezeve të diellit dhe kushteve klimatike.
- **Menaxhimi nga institucionet dhe bizneset:** Të gjitha komunat, institucionet qendrore dhe lokale, spitalet, ndërmarrjet publike dhe subjektet afariste private, të sigurojnë grumbullimin, transportimin, trajtimin dhe mbikëqyrjen e mbeturinave në mënyrë të rregullt dhe në përputhje me standardet mjedisore.
- **Informimi:** Të intensifikohen aktivitetet e informimit dhe ndërgjegjësimin të qytetarëve lidhur me rëndësinë e depozitimit të mbeturinave në vendet e përcaktuara dhe shmangien e përzierjes së tyre.

2. Zgjidhja Afatgjatë dhe Ndryshimi i Lokacionit

- **Ndalimi i rreptë:** Ndalohet rreptësisht grumbullimi i mbeturinave urbane në lokacione apo forma që rrezikojnë shëndetin publik, posaçërisht në afërsi të institucioneve edukative, parqeve përfshirë terrenet sportive dhe parqet e lodrave, në rrugët kryesore e me frekuentueshmëri të lartë nga kalimtarët, afër bizneseve të ushqimit dhe të gastronomisë.
- **Obligimet për institucionet publike dhe bizneset:** Urdhërohen të gjitha autoritetet përgjegjëse, si dhe subjektet private e publike, të ndërmarrin masat e nevojshme për eliminimin e ekspozimit të mbeturinave në këto zona me rrezikshmëri të lartë.
- **Menaxhimi i mbeturinave në gastronomi:** Komunat dhe ndërmarrjet menaxhuese obligohen të vendosin një **sistem të ndarë** për grumbullimin e mbeturinave nga bizneset e gastronomisë dhe marketeve, me qëllim që të parandalohet stërmbyshja e kontejnerëve të përbashkët të dedikuar për banorët.

3. Ndalimi i Mbetjeve Inerte dhe Ndërtimore

- Të vendosen shenja të qarta paralajmëruese ku specifikohet ndalimi i hedhjes së mbetjeve inerte dhe materialeve ndërtimore në hapësira publike dhe pranë kontejnerëve të mbeturinave urbane.

4. Obligimi për Raportim, Kushtëzimi dhe Masat Ndëshkuese

Menaxhimi i mbeturinave urbane është kompetencë ekskluzive dhe obligim ligjor i Komunës. Mosveprimi i shpejtë në këtë pikë, specifikisht gjatë muajve të verës dhe paraqitjes së brejtësve, ngarkon Komunat me përgjegjësi direkte për cenimin e shëndetit të qytetarëve. Për të siguruar zbatueshmërinë e kësaj urdhërese:

- **Afati i Raportimit:** Të gjitha Komunat obligohen që brenda **7 ditëve** nga dita e pranimin të kësaj urdhërese, të dorëzojnë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

planin dhe provat e masave të marra emergjente (përfshirë dëshmitë për deratizim dhe rritjen e frekuencës së mbledhjes).

- **Kushtëzimi i Fondeve:** Moszbatimi i këtyre masave urgjente do të shërbejë si bazë direkte për kushtëzimin e financimit të projekteve nga MMPH.
- **Masat Ndëshkuese:** Inspektorati Qendror i MMPH-së, në bashkëpunim me atë Komunal, autorizohet që pas kalimit të këtij afati kohor, të fillojë inspektime të jashtëzakonshme në terren dhe të shqiptojë gjoba maksimale ndaj të gjithë atyre zyrtarëve, institucioneve apo operatorëve që nuk e zbatojnë këtë urdhëresë.

Kjo urdhëresë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe shpërndarjes te palët përgjegjëse.



Fitorë Pacoll Dajli
Ministre e Ministrisë së
Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Urdhëresa u dërgohet:

- Kabinetit të Ministres të MMPH-se;
- Sekretari i Përgjithshëm;
- Inspektorati i Ministrisë;
- Divizioni për Komunikim Publik;
- AMMK;
- DMM;
- Të gjitha Komunave;
- Arkivi i MMPH-së.